
	<b>Procedura për tregtimin e energjisë elektrike</b>	<b>PR-MO-11</b>
	<i>vers. 1.0</i>	<i>Faqe 1 nga 20</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

## **PROCEDURA PËR TREGTIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

**Gusht 2018**

	<b>Procedura për tregtimin e energjisë elektrike</b>	<b>PR-MO-11</b>
	<i>vers. 1.0</i>	<i>Faqe 2 nga 20</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		


## I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1 Baza ligjore

- 1) Draftimi i kësaj Procedure është bërë nga Operatori i Sistemit Transmetues të Kosovës (KOSTT) në përputhje me Nenin 22, Organizimi i tregut të energjisë elektrike, të Ligjit për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085.
- 2) Kjo Procedurë do të shqyrtohet nga Zyra e Rregullatorit për Energji (tash e tutje ZRrE) dhe aprovohet e publikohet, në përputhje me dispozitat relevante të Ligjit për Energjinë, Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

### Neni 2 Objekti dhe qëllimi

- 1) Objekt i kësaj Procedure është të përcaktojë parimet e përgjithshme të blerjes dhe shitjes së energjisë elektrike.
- 2) Për detaje më specifike, kompanitë duhet të zhvillojnë procedurën e brendshme të bazuar në funksionin e tyre në treg, e cila duhet të jetë në përputhje me këtë Procedurë.
- 3) Qëllimi i kësaj Procedure është:
  - të përcaktojë mënyra efikase dhe praktike të tregimit të energjisë elektrike për aktivitetet e energjisë të referuara në paragrafin 1, të Nenit 6 të kësaj Procedure,
  - të garantojë prokurimin ekonomik të energjisë elektrike,
  - të promovojë konkurrencën në procesin e blerjes dhe shitjes së energjisë elektrike,
  - të garantojë transparencë dhe trajtim të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike gjatë procesit të blerjes dhe shitjes së energjisë elektrike.


	<b>Procedura për tregtimin e energjisë elektrike</b>	<b>PR-MO-11</b>
	<i>vers. 1.0</i>	<i>Faqe 3 nga 20</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

### Neni 3 Parimet bazë

- 1) Procedura për tregtimin e energjisë elektrike duhet të zbatohet në përputhje me parimet e barazisë, konkurrencës, transparencës dhe ruajtjes së konfidencialitetit.
- 2) Procedura për tregtimin e energjisë elektrike është e ndarë në dy pjesë, varësisht nga periudha kohore për liferimin e energjisë elektrike:
  - Tregtimi Afatgjatë – nënkupton shitjen/blerjen e energjisë elektrike për një periudhë prej një muaji apo më gjatë,
  - Tregtimi Afatshkurtë – nënkupton shitjen/blerjen e energjisë elektrike për një periudhë:
    - a) deri në një muaj
    - b) një ditë përpara (day ahead)
    - c) brenda ditës (intraday) që nga momenti i pranimit/dërgimit të energjisë elektrike.
- 3) Tregtimet e energjisë elektrike të definuara nëparagrafin 2 të këtij Neni, mund të realizohen nëpërmjet kontratave bilaterale ose nëpërmjet bursave të energjisë.
- 4) Tregtimet e energjisë elektrike që realizohen nëpërmjet bursave të energjisë nuk përfshihen në këtë Procedurë.

### Neni 4 Definicionet

- 1) Në këtë Procedurë do të përdoren termet dhe shkurtesat si në vijim:
  - **Ofertë:** nënkupton dokumentacionin e kompletuar dhe korrespondencën në lidhje me energjinë e elektrike të blerë /të shitur që i është liferuar Blerësit/Shitësit. Në rastin e blerjeve/shitjeve afat shkurtra, oferta i referohet vetëm çmimit, ndërsa në rastin e blerjeve/shitjeve afat gjata oferta i referohet dokumentacionit të plotë, duke përfshirë çmimin.
  - **Ofertues :** do të thotë Tregtari i energjisë elektrike që paraqet një Ofertë.
  - **Kalendari i Ofertave :** nënkupton kalendarin që i përmban ditët kur do të realizohen proceset e blerjeve/shitjeve të planifikuara për tregtim afatgjatë.
  - **Kapacitetet transmetuese ndër-kufitare:** janë kapacitetet interkonektive në kufijtë e Kosovës të siguruara nga blerësi/shitësi apo tregtarët për të mundësuar blerjen/shitjen ndër-kufitare të energjisë elektrike.
  - **Tregtimi i energjisë elektrike:** paraqet transferimin e energjisë elektrike me një vlerë të caktuar dhe në një periudhë të caktuar kohore nga/tek tregtarët e energjisë elektrike

	<b>Procedura për tregtimin e energjisë elektrike</b>	<b>PR-MO-11</b>
	<i>vers. 1.0</i>	<i>Faqe 4 nga 20</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

tek/nga Blerësi/Shitësi, sipas kushteve të definuara në kontratën relevante të shitjes/blerjes, dhe në përputhje me këtë Procedurë.

- **Tregtari i energjisë elektrike:** është çdo person juridik, kompani vendase apo e huaj, që ushtron aktivitet të licencuar, për tregtimin e energjisë elektrike me shumicë.
- **Blerësi/Shitësi:** nënkupton operatorin e sistemit të shpërndarjes, operatorin e sistemit të transmetimit, kompanitë publike të energjisë elektrike dhe kompani të tjera të energjisë elektrike për të cilat është vendosur detyrimi i shërbimit publik për shitjen dhe /ose blerjen e energjisë elektrike sipas licensave të lëshuara nga ZRrE.
- **Kërkesa/Ftesa për oferta:** do të thotë dokumenti zyrtar që Blerësi/Shitësi u drejton publikisht tregtarëve të energjisë elektrike për paraqitje të ofertave, hartuar në formën e parashikuar në këtë Procedurë.
- **Regjistri i tregtarëve të Energjisë Elektrike:** do të thotë një regjistër të të gjithë tregtarëve të energjisë elektrike që mbahet nga Blerësi/Shitësi, me kontaktet e personave përgjegjës për të siguruar informacionin për procesin e blerjes /shitjes.
- **Kontrata kornizë:** çdo format i kontratës i cili përdoret nga kompanitë në Procedurën e tregtimit të energjisë elektrike qoftë ajo e brendshme ose e bazuar në praktikat më të mira të jashtme, siç është Marrëveshja e përgjithshme EFET e cila duhet të përmbajë të dhënat bazike të përcaktuara me nenin 10 të kësaj Procedure.
- **Marrëveshja e Përgjithshme EFET:** nënkupton Marrëveshjen e Përgjithshme Versioni 2.1(a)/ 21 shtator 2007, publikuar nga Federata Evropiane e Tregtarëve të Energjisë (EFET), bashkë me shabllonet përcjellëse të Listës së Zgjedhjes dhe Kontratën Individuale.


## Neni 5 Përgjegjësitë

Blerësi/Shitësi është përgjegjës për definimin e qartë të të gjitha detajeve të nevojshme për blerjen/shitjen e caktuar të energjisë elektrike, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në: kapacitetin (MW), sasinë e energjisë elektrike (MWh), periudhën kohore për liferim dhe detajet e tjera të nevojshme për blerje/shitje të energjisë elektrike. Këto vlera do të kalkulohen në përputhshmëri me nevojat e Blerësit/Shitësit .

## Neni 6 Zbatimi

Procedura për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike duhet të zbatohet nga:

- operatori i sistemit transmetues për mbulimin e humbjeve në rrjetin transmetues, programin e kompensimit dhe shërbimet ndihmëse,

	<b>Procedura për tregtimin e energjisë elektrike</b>	<b>PR-MO-11</b>
	<i>vers. 1.0</i>	<i>Faqe 5 nga 20</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- operatori i sistemit të shpërndarjes për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe shërbimet ndihmëse,
- prodhuesit e energjisë elektrike - për shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike,
- kompanitë e energjisë elektrike për të cilat është vendosur detyrimi i shërbimit publik për shitjen dhe/ose blerjen e energjisë elektrike.

### Neni 7


#### Deklarata për konfliktin e interesit

Para publikimit të procesit tenderues për blerje/shitje të energjisë elektrike, çdo i punësuar i Blerësit/Shitësit që është i autorizuar për tender të caktuar duhet të nënshkruajë një deklaratë me të cilën ajo/ai deklaron se ajo/ai nuk ka konflikt të interesit me ofertuesit potencial, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### Neni 8

#### Kërkesat ligjore dhe administrative

- 1) Për çdo tregtim të energjisë elektrike, blerësi/shitësi duhet të kërkojë dokumentet e nevojshme si janë të caktuara në këtë procedurë e të cilat janë të paraqitura në vijim:
  - Dëshmitë për aftësitë legale
  - Certifikatën nga regjistri i bizneseve, regjistri gjyqësor (tregtim), regjistri profesional i ekspertëve të kualifikuar ose ndonjë regjister tjetër ekuivalent ose ndonjë certifikatë ekuivalente.
  - Licencën për tregtim të energjisë elektrike, të lëshuar nga ZRrE për tregtarët që janë themeluar ose regjistruar në Kosovë, ose, nga shtetet përkatëse për tregtarë me energji elektrike që janë themeluar ose regjistruar jashtë Kosovës e që është e njohur nga ZRrE në pajtim me legjislacionin në fuqi.
  - Dokumentacionin e lëshuar nga institucioni kompetent i shtetit përkatës që nuk është më i vjetër se 6 muaj nga dita e dorëzimit të ofertës, që vërteton se:
    - tregtari nuk është në procesin e bankrotimit,
    - tregtari ose përfaqësuesi ligjor i kompanisë nuk janë të dënuar me ndonjë vendim gjyqësor për vepra penale ose kundërvajtje në lidhje me afarizmin e ndërmarjes.
  - Dëshmitë për aftësi biznese: Informacionin e biznesit apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar nga kompania.
- 2) Tregtarë që nuk i përmbushin kërkesat e parashtruara të kësaj procedure do të konsiderohen si jo-legjitim.

	<b>Procedura për tregtimin e energjisë elektrike</b>	<b>PR-MO-11</b>
	<i>vers. 1.0</i>	<i>Faqe 6 nga 20</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- 3) Përveç dokumenteve të lartëcekura, blerësi/shitësi mund të kërkojë edhe dokumente të tjera shtesë, të parapara me Procedurat e Brendshme.

## II. Tregtimi afatshkurtë i energjisë elektrike

### Neni 9


#### Parimet themelore për tregtimin afatshkurtë të energjisë elektrike

- 1) Tregtimi afatshkurtë i energjisë elektrike organizohet nëpërmes një mekanizmi të kontratave kornizë dhe ankandeve. Kontrata Kornizë është kontratë e përgjithshme, forma e së cilës zgjedhet nga blerësit/shitësit duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, në Marrëveshjen e përgjithshme EFET, por që duhet të përmbajë të dhënat të parapara në nenin 10 të kësaj Procedure. Ankandet përdoren për përzgjedhjen e Ofertave fituese për blerjet/shitjet afatshkurta të energjisë elektrike nga të gjitha Ofertat e dorëzuara nga Ofertuesit që paraprakisht kanë përmbyllur Kontratën Kornizë.
- 2) Ftesa për kualifikimin e tregtarëve për nënshkrimin e Kontratës Kornizë për blerjen/shitjen e energjisë elektrike është e hapur vazhdimisht për të gjithë tregtarët që kanë të drejtë ligjore për të tregtuar energjinë elektrike, pa ndonjë afat të fundit për dorëzim.

### Neni 10

#### Nënshkrimi i Kontratës Kornizë

- 1) Kontratat Kornizë duhet të jenë jo-diskriminuese pasi që Blerësi/Shitësi duhet të jetë neutral ndaj të gjithë tregtarëve.
- 2) Blerësi/Shitësi do t'i dërgojë tregtarëve të kualifikuar Kontratën Kornizë për revidimin dhe adaptimin e saj. Asnjë nga parimet themelore të kontratës nuk mund të ndryshohet.
- 3) Kontrata Kornizë përmban por nuk kufizohet vetëm në pikat në vijim:
  - Të dhënat e kompanisë (emrin, adresën, numrin e regjistrimit) dhe emrat e personave përgjegjës
  - Informatat për blerjet/shitjet (njësitë prodhuese, sasinë e energjisë elektrike /fuqinë, pikën e qasjes etj.)
  - Personat kontaktuese të dy palëve (Blerësit/Shitësit dhe tregtarit).
- 4) Kontrata Kornizë do të nënshkruhet në dy kopje. Secila palë e mbanë nga një kopje origjinale të shtypur dhe nënshkruar.


	<b>Procedura për tregtimin e energjisë elektrike</b>	<b>PR-MO-11</b>
	<i>vers. 1.0</i>	<i>Faqe 7 nga 20</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- 5) Kontrata Kornizë lidhet për një periudhë të pacaktuar kohore. Ndërmjet dispozitave tjera, Kontrata Kornizë do të përmbajë kushtet për shkëputjen e kontratës.

## Neni 11

### Dorëzimi i Ofertave për tregtimin afatshkurtë të energjisë elektrike

- 1) Procesi i ankandit do të organizohet për çdo blerje/shitje afatshkurtë të energjisë elektrike. Detajet e ankandit, duke përfshirë kohën e hapjes dhe mbylljes së ankandit, do të definojnë për çdo blerje/shitje afatshkurtë të energjisë elektrike dhe do të komunikohen të gjithë bartësve të Kontratës Kornizë me e-mail apo thirrje telefonike ose përmes platformës së Blerësit/Shitësit.
- 2) Të gjitha bisedat telefonike ndërmjet Blerësit/Shitësit dhe ofertuesve potencial, për tregtimin afatshkurtë të energjisë elektrike dhe kushtet e tregtimit, mund të realizohen nëpërmes linjave telefonike të përzgjedhura dhe të gjitha duhet të incizohen e të ruhen në medime dhe sisteme të përshtatshme. Të gjitha detajet e bisedave telefonike nga ky paragraf duhet të konfirmohen sa më shpejt që është e mundur me shkrim, me e-mail ose faks.
- 3) Regjistrimet e thirrjeve telefonike nga paragrafi 2 i këtij Neni do të ruhen për një periudhë prej së paku 3 vitesh për nevojat të rishikimit të brendshëm dhe të jashtëm.
- 4) Ofertat për blerje / shitje të ankandit në paragrafin 1 të këtij Neni mund të dorëzohen vetëm nga Ofertuesit që kanë Kontratë Kornizë të vlefshme për tregtim afatshkurtë të energjisë elektrike.
- 5) Çdo ftesë për ankand do të përmbajë së paku të dhënat për: sasinë e energjisë elektrike që duhet të blehet/shitet (MWh ose MWh/h), periudhën kohore përkatëse dhe pikën e liferimit/tërheqjes së energjisë elektrike. Të gjitha detajet tjera të transaksionit do të jepen në afatet dhe kushtet e çdo ankandi.
- 6) Aktivizimet e blerjeve/shitjeve afatshkurtë të energjisë elektrike brenda zonës ofertuese të Kosovës duhet të bëhen konform Procedurës së Skedulimit.
- 7) Aktivizimet e blerjeve/shitjeve afatshkurtë të energjisë elektrike jashtë zonës ofertuese të Kosovës duhet të jenë në përputhje me procesin e skedulimit ndër-kufitar regional.
- 8) Kapacitetet ndër-kufitare që nevojiten për një tregtim afatshkurtë të caktuar të energjisë elektrike do të sigurohen nga Blerësi/Shitësi ose Ofertuesi. Detajet dhe përgjegjësinë për

	<b>Procedura për tregtimin e energjisë elektrike</b>	<b>PR-MO-11</b>
	<i>vers. 1.0</i>	<i>Faqe 8 nga 20</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

sigurimin e kapacitetit ndër-kufitar do të definohej në procesin e ofertimit për çdo blerje/shitje afatshkurtë të energjisë elektrike.

- 9) Blerësi/Shitësi do të publikojë rezultatet e ankandit në përputhje me dokumentacionin e ankandit.
- 10) Procesi i ofertimit nuk e obligon Blerësin/Shitësin të marrë/ofrojë gjithë sasinë e paraqitur në njoftimin fillestar që ofrohet, dhe këto mund të jenë të ndashme, sikurse edhe ofertat që mund të jenë të ndashme.

## Neni 12

### Kriteret për vlerësimin e ofertave


- 1) Kriteri përzgjedhës për blerje afatshkurtë të energjisë elektrike është kostoja ekonomike më e favorshme e Ofertës, letrat me vlerë siç kërkohen, transaksionet e hapura me ofertuesit ose volumi i kapaciteteve, dhe që i plotëson të gjitha kërkesat e tenderit. Në rastet kur Ofertat kanë të njëjtën sasi dhe çmim, do të kontaktohen kompanitë garuese të cilat kanë pasur çmimin e njëjtë dhe do t'iu jepet mundësia për përmisim të çmimit.
- 2) Procesi i ofertimit mund të përfshijë kërkesën për rishikim të çmimit dhe volumeve të kapaciteteve. Kërkesa për rishikim duhet t'i dorëzohet të gjithë ofertuesve.
- 3) Kriteri përzgjedhës për shitje afatshkurtë të energjisë elektrike është çmimi më i lartë i Ofertës që i plotëson të gjitha kërkesat e tenderit. Në rastet kur Ofertat kanë të njëjtën sasi dhe çmim, do të kontaktohen kompanitë garuese të cilat kanë pasur çmimin e njëjtë dhe do t'iu jepet mundësia për përmisim të çmimit.
- 4) Blerësi/shitësi do të nënshkruajë Kontratën Individuale për çdo Ofertë për blerje/ shitje fituese me tregtarin përkatës. Një Shabllon i Kontratës Individuale është dhënë në Shtojcën 4 të Procedurës por mund të përdoret edhe shabllon tjetër i njohur nderkombëtarisht.

## Neni 13

### Përsëritja e procesit të ofertimit gjatë tregimit afatshkurtë të energjisë elektrike

- 1) Në rastet kur nuk është pranuar asnjë Ofertë valide për Blerje/Shitje afatshkurtë të energjisë elektrike, procesi i ofertimit do të përsëritet.
- 2) Përsëritja e procesit të ofertimit do t'i komunikohet në të njëjtën mënyrë të gjithë tregtarëve të energjisë elektrike që iu është dërguar ftesa në raundin paraprak.



	<b>Procedura për tregtimin e energjisë elektrike</b>	<b>PR-MO-11</b>
	<i>vers. 1.0</i>	<i>Faqe 9 nga 20</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- 3) Procesi i përsëritur i ofertimit mund të fillojë menjëherë pasi të jetë bërë komunikimi sipas paragrafit 2 të këtij Neni.
- 4) Në rast se shqyrtimi i Ofertave, vlerësimi dhe krahasimi nuk është i mundur për shkak të formatit jo-adekuat të Ofertës atëherë Oferta do të diskualifikohet.

#### Neni 14

##### Pagesa, faturimi, barazimi përfundimtar

- 1) I tërë procesi i barazimit përfundimtar për sasi të energjisë elektrike të liferuara ndërmjet palëve, vlerat përkatëse financiare dhe faturimi duhet të bazohet në vlerat neto të agreguara nga kontratat individuale të nënshkruara.
- 2) Pagesa dhe faturimi do të bëhen në bazë të marrëveshjes dhe linjave kreditore të ofruara nga ofertuesit në përputhje me Kontratën Kornizë, të përdorur nga kompania.

#### Neni 15

##### Raportimi për tregtimin e energjisë elektrike


- 1) Të gjitha tregtimet e energjisë elektrike duhet të dokumentohen në mënyrë të saktë. Asnjë blerje/shitje nuk duhet të realizohet pa bashkangjitur dokumentacionin e plotë të kërkuar.
- 2) Deri në ditën e 10-të punës të çdo muaji kalendarik Blerësi/Shitësi duhet të dorëzojë në ZRrE një kopje të raportit përmbledhës final të gjitha tregtimeve të energjisë elektrike për muajin e kaluar, duke përfshirë të gjitha kontratat individuale të përmbyllura gjatë tregimit.

### III. Tregtimi afatgjatë i energjisë elektrike

#### Neni 16

##### Parimet themelore për tregtimin afatgjatë të energjisë elektrike

- 1) Blerjet/shitjet afatgjata të energjisë elektrike organizohen nëpërmes një mekanizmi tenderues për çdo transaksion.
- 2) Ftesa për Ofertat për blerje/shitje afatgjata hapet për çdo transaksion ndaras, me afate të fundit për dorëzimin e tyre të saktësuar mirë.
- 3) Procedura mund të organizohet në LOT-e. Ofertuesit mund të bëjnë Ofertë për çdo LOT që ata janë të interesuar në sasi që disponojnë. Përkatësisht, Blerësi / Shitësi mund të zgjedhë sasi të pjesshme nga Ofertat.
- 4) Me njoftimin e duhur paraprak, procedura e hapur mund të anulohet më vonë, varësisht nga rrethanat e krijuara në kompani. Hapja e tenderit nuk është një detyrim i vendosur për

	<b>Procedura për tregtimin e energjisë elektrike</b>	<b>PR-MO-11</b>
	<i>vers. 1.0</i>	<i>Faqe 10 nga 20</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

të blerë ose shitur ndonjë ose të gjitha pjesët dhe mund të anulohet plotësisht ose pjesërisht në çdo kohë, me një njoftimin të duhur paraprak.

### Neni 17


#### Dorëzimi i Ofertave për tregtimin afatgjatë të energjisë elektrike

- 1) Për ndërlidhjen me të gjithë ofertuesit potencial në procesin e blerjes/shitjes së energjisë elektrike, Blerësi/Shitësi duhet të shfrytëzojë platformën elektronike, faqet elektronike zyrtare apo mjetet tjera të komunikimit (e-mailin, faksin ose postën) si definohet në dokumentacionin e tij tenderues.
- 2) Nuk lejohen thirrjet telefonike ndërmjet Blerësit/Shitësit dhe ofertuesit potencial gjatë procesit të tregtimit afatgjatë të energjisë elektrike- përveç në qoftë se është specifikuar në dokumentacionin tenderues si një mekanizëm i negociatave tenderuese.
- 3) Të gjitha thirrjet telefonike ndërmjet Blerësit/Shitësit dhe ofertuesve potencial në lidhje me tregtimin afatgjatë të energjisë elektrike dhe kushtet e dhëna në paragrafin 2 të këtij Neni mund të realizohen vetëm nëpërmes linjave telefonike të përzgjedhura dhe të gjitha duhet të regjistrohen. Të gjitha detajet e thirrjeve telefonike nga ky paragraf duhet të konfirmohen sa më shpejtë që është e mundur me shkrim, me e-mail ose me faks.
- 4) Regjistrimet e thirrjeve telefonike nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij Neni do të ruhen për një periudhë prej së paku 3 vitesh për nevoja të rishikimit të brendshëm dhe të jashtëm.
- 5) Blerësi/Shitësi duhet të mirëmbajë Kalendarin e Ofertave dhe Regjistrin e tregtarëve të energjisë elektrike që marrin pjesë si Ofertues në tenderët e blerjes/shitjes afatgjatë të energjisë elektrike në 5 vitet e fundit.
- 6) Këto të dhëna do të dërgohen ZRrE-së. Publikimi i këtyre të dhënave mund të rregullohet me Procedurat e Brendshme të kompanive.

### Neni 18

#### Formati i Ofertave

- 1) Në çdo procedurë tenderuese për tregtim afatgjatë të energjisë elektrike, për Ofertën e dorëzuar duhet të kërkohen së paku informatat në vijim:
  - Emri i Ofertuesit,
  - kapacitetin e ofruar /periudhën (MW),
  - çmimin njësi (euro/MWh),
  - pikën e liferimit/tërheqjes të energjisë elektrike,
  - profilin e liferimit (MWh/h),
  - Deklaratën e integritetit të ofertuesit (Shtojca 1),
  - Garancioni bankar për ofertën.

	<b>Procedura për tregtimin e energjisë elektrike</b>	<b>PR-MO-11</b>
	<i>vers. 1.0</i>	<i>Faqe 11 nga 20</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- 2) Të gjitha Ofertat dorëzohen për tërë kohëzgjatjen e periudhës për të cilën energjia elektrike është blerë/shitur. Kapaciteti i ofruar në Oferta duhet të jepet në Lote: ndërmjet 1 MW dhe kapacitetit total të kërkuar. Kjo nuk duhet t'u pamundësojë tregtarëve të energjisë elektrike që të dorëzojnë Oferta më të vogla se kapaciteti maksimal i kërkuar/ofruar, përveç në qoftë se definohet ndryshe në dokumentacionin tenderues.

### Neni 19


#### Kriteret për vlerësimin e Ofertave

- 1) Kriteri për përzgjedhjen e Ofertave gjatë blerjes afatgjatë të energjisë elektrike është kostoja më e favorshme ekonomike e ofertës, letrat me vlerë siç kërkohen, transaksionet e hapura me ofertuesit ose volumi i kapaciteteve, struktura e pagesës siç kërkohet dhe që i përmbushë kërkesat e tenderit. Në rastet kur ofertat kanë të njëjtën sasi dhe të njëjtin çmim do të kontaktohen kompanitë garuese të cilat kanë pasur çmimin e njëjtë dhe do t'u jepet mundësia për përmisim të çmimit.
- 2) Kriteri për përzgjedhjen e Ofertave gjatë shitjes afatgjatë të energjisë elektrike është çmimi më i lartë ofertës, marrë në konsideratë letrat me vlerë siç kërkohen dhe që i përmbushë kërkesat e tenderit. Në rastet kur ofertat kanë të njëjtën sasi dhe të njëjtin çmim, do të kontaktohen kompanitë garuese të cilat kanë pasur çmimin e njëjtë dhe do t'u jepet mundësia për përmisim të çmimit.
- 3) Blerësi/Shitësi do të njoftojë Ofertuesin për rezultatet e tenderimit në përputhje me dokumentacionin tenderues.
- 4) Pas shpalljes së fituesit për një proces të Blerjes/Shitjes afatgjatë të energjisë elektrike, Blerësi/Shitësi dhe fituesi do të nënshkruajnë kontratën.

### Neni 20

#### Procedura administrative e ankimimit në tregtimin afatgjatë të energjisë elektrike

- 1) Çdo Ofertues mund të kërkojë rishikim të procedurës administrative e cila ndiqet për një Blerje/Shitje, kur gjykon se një vendim i Blerësit/Shitësit është në kundërshtim me këtë Procedurë, duke ndjekur hapat e mëposhtëm:
  - Ofertuesi paraqet një ankesë me shkrim për shkeljen, përmes e-mailit të Blerësit/Shitësit, brenda 24 orësh nga momenti i njoftimit të ofertuesit të kualifikuar.
  - Në këtë ankesë, ankimuesi duhet të paraqesë emrin dhe adresën, referimin për procedurën konkrete ku ka marrë pjesë, bazën ligjore dhe përshkrimin e shkeljes së pretenduar.

	<b>Procedura për tregtimin e energjisë elektrike</b>	<b>PR-MO-11</b>
	<i>vers. 1.0</i>	<i>Faqe 12 nga 20</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- Kur merr një ankesë, Blerësi/Shitësi është i detyruar të miratojë vendimin për praninë ose jo të ankesës brenda 24 orësh nga marrja e ankesës.
- 2) Palët e pakënaqura me Vendimin e cekur në paragrafin 1 pika 3 të këtij Neni, mund të iniciojnë konflikt administrativ, në pajtim me Ligjin për Konfliktet Administrative.
  - 3) Procedura e ankimimit nga paragrafi 1 nuk do të shtyjë transaksionin për blerjen/shitjen e energjisë elektrike.

### Neni 21

#### Kontratat afatgjata për tregtimin e energjisë elektrike

- 1) Blerja ose Shitja e energjisë elektrike nga kompanitë e energjisë të cilave iu kemi referuar në Nenin 6, paragrafi 1, kryhet mbi bazë të kontratave që lidhen si rrjedhojë e kriterëve të përcaktuara në këtë Procedurë.
- 2) Kontratat duhet të hartohen në përputhje me legjislacionin në fuqi të sektorit të energjisë.

### Neni 22


#### Publikimi i informatave për tregtimin afatgjatë të energjisë elektrike

- 1) Për secilën Blerje/Shitje të energjisë elektrike, gjithë informacioni i specifikuar në Procedurat e brendshme duhet të publikohet në Kalendarin e Ofertave i cili duhet të vendoset në dispozicion të pjesëmarrësve të tregut në faqen elektronike të Blerësit/Shitësit.
- 2) Informatat për blerjen/shitjen e energjisë elektrike do të publikohen në gjuhën Shqipe, Angleze dhe Serbe në faqen elektronike zyrtare të Blerësit/Shitësit. Në rast mospërputhjes duhet të mbizotërojë informacioni në gjuhën Shqipe.
- 3) Blerësi / Shitësi duhet të përpilojë raporte vjetore të cilat do të dorëzohen në ZRrE. Publikimi i këtyre raporteve do të rregullohet tutje me Procedurat e tyre të brendshme.

### Neni 23

#### Përsëritja e procesit ofertues për tregtimin afatgjatë të energjisë elektrike

- 1) Në rastet kur nuk ka ofertë të vlefshme, procesi duhet të përsëritet.
- 2) Përsëritja e procesit të ofertimit duhet të shpallet për të gjithë tregtarët e energjisë elektrike që kishin marrë pjesë në raundin paraprak.

	<b>Procedura për tregtimin e energjisë elektrike</b>	<b>PR-MO-11</b>
	<i>vers. 1.0</i>	<i>Faqe 13 nga 20</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

3) Në rastet kur rishikimi, evaluimi dhe krahasimi nuk janë të mundshëm për shkak të formatit jo-adekuat të ofertës dhe/ose informatave të pamjaftueshme ose të paqarta të ofertës, oferta do të diskualifikohet.

#### Neni 24 Pagesat

Pagesat rregullohen nga secila kompani me Procedura të brendshme dhe me kontrata të lidhura me palët ofertuese.

#### Neni 25 Monitorimi i tregimit të energjisë elektrike


- 1) Të gjitha veprimet e blerjes/shitjes së energjisë elektrike duhet të dokumentohen në mënyrë të saktë. Asnjë blerje/shitje nuk do të kryhet pa dokumentacionin shoqërues të kërkuar.
- 2) Deri në ditën e 10-të të punës të çdo muaji kalendarik Blerësi/Shitësi paraqet në ZRrE një kopje të raportit përfundimtar për shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha ofertave, një kopje të gjithë ankesave të paraqitura, nëse ka, si dhe përgjigjet për ankesat.
- 3) Blerësi/Shitësi është i detyruar të paraqesë në mënyrë teransparente në ZRrE të gjithë dokumentacionin e kërkuar, për tregtimin e energjisë elektrike, brenda autoritetit të ZRrE-së për monitorim.
- 4) ZRrE shqyrton të dhënat e paraqitura nga Blerësi/Shitësi dhe vlerëson nëse procesi i ofertimit dhe vlerësimit në muajin paraprak përputhet me kriteret dhe dispozitat e kësaj Procedure.
- 5) Në rast se ZRrE vëren parregullsi në proceset e ofertimit dhe/ose vlerësimit të cilat mund t'i ngarkohen Blerësit/Shitësit dhe Ofertuesve, ZRrE mund të vendosë një masë administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Neni 26 Sanksionet

Për shkeljen e dispozitave të kësaj Procedure, kur nuk përbën vepër penale, ZRrE vepron në përputhje me dispozitat relevante të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

#### Neni 27 Hyrja në fuqi dhe validiteti

Kjo Procedurë do të hyjë në fuqi menjëherë pas aprovimit nga Bordi i ZRrE.

	<b>Procedura për tregtimin e energjisë elektrike</b>	<b>PR-MO-11</b>
	<i>vers. 1.0</i>	<i>Faqe 14 nga 20</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

## SHTOJCA 1 – Deklarata e integritetit

\_\_\_\_\_

(Emri i Kompanisë Ofertuese)

\_\_\_\_\_

(Numri Fiskal)

\_\_\_\_\_

(Adresa e Ofertuesit)

Për nevoja të Ofertimit Publik në lidhje me liferimet e energjisë elektrike, për Blerësin/Shitësin \_\_\_\_\_ të publikuar më \_\_\_\_\_, ne bëjmë deklaratën në vijim:

### DEKLARATA E INTEGRITETIT

Me të cilën deklarojmë që, si Ofertues në këtë procedurë të prokurimit:

- Ne garantojmë korrektësi të plotë në procedurë përkatëse,
- Ne garantojmë se nuk ekziston ndonjë praktikë e ndaluar në lidhje me procedurën ofertuese përkatëse, e cila përfshinë veprime si :korrupsioni, mashtrimi, ofrimi apo premtimi i disa përparësive të parregullta të cilat mund të ndikojnë në veprimet e ndonjë të punësuar, dhe
- Ne pajtohemi me rishikimin e tërë procedurës së prokurimit nga një ekspert i pavarur dhe pranojmë detyrimet dhe sanksionet (penalitet kontraktuese, shkëputjen e pakusht të kontratës) në qoftë se janë shkelur rregullat.

Në \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_

(vendi) (data)

\_\_\_\_\_

(Emri dhe Mbiemri i Personit të Autorizuar të Ofertuesit)

\_\_\_\_\_

(Nënshkrimi)



## SHTOJCA 2 – Shablloni për ftesën për tenderim

Blerësi: \_\_\_\_\_

Adresa: \_\_\_\_\_

Shpallë

# TENDERIM PËR FTESË PËR OFERTIM AFATGJATË PËR BLERJE TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Data: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ (këtu e tutje i quajtur Blerësi) shpall tenderim për blerjen e energjisë elektrike dhe fton Ofertuesit që të paraqesin ofertat e tyre si specifikohet më poshtë:

### 1. LOT 1

PERIUDHA E LIFERIMIT:

Nga \_\_\_\_\_ deri në \_\_\_\_\_

PROFILI I KAPACITETIT DHE LIFERIMIT :

\_\_\_ MWh/h nga \_\_\_ h deri në \_\_\_ h

Të gjitha specifikimet e kohës i referohen CET.

### LOT 2

PERIUDHA E LIFERIMIT:

Nga \_\_\_\_\_ deri në \_\_\_\_\_

PROFILI I KAPACITETIT DHE LIFERIMIT:

\_\_\_ MWh/h nga h \_\_\_ deri në h \_\_\_

Të gjitha specifikimet e kohës i referohen CET.

Ofertuesi mund të ofrojë kapacitet jo më të vogël se 1 MWh/h.

.

.

.


### LOT X

PERIUDHA E LIFERIMIT:

Nga \_\_\_\_\_ deri në \_\_\_\_\_

PROFILI I KAPACITETIT DHE LIFERIMIT:

\_\_\_ MWh/h nga h \_\_\_ deri në h \_\_\_

	<b>Procedura për tregtimin e energjisë elektrike</b>	<b>PR-MO-11</b>
	<i>vers. 1.0</i>	<i>Faqe 16 nga 20</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

Të gjitha specifikimet e kohës i referohen CET.

Ofertuesi mund të ofrojë kapacitet jo më të vogël se 1 MWh/h.

Ofertuesi mund të ofrojë një ose më shumë LOT – e.

## **2. NDËRPRERJA E PRANIMIT**

Blerësi ka të drejtë të ndërpres pranimin e energjisë elektrike gjatë festave në Kosovë. Çdo ndërprerje duhet të shpallet së paku dy ditë pune para fillimit të ndërprerjes.

## **3. PIKA E LIFERIMIT DHE RISK TRANSFER**

E liferuar në Kufi (DAP sipas Incoterms 2010) kufiri i Kosovës, në anën Kosovare të kufirit, me kapacitet ndër-kufitar të Blerësit ose Ofertuesit.

Ofertuesi gjithashtu mund të ofrojë liferimin e energjisë elektrike brenda Kosovës.

Oferta duhet të përmbajë specifikimin e pikës së liferimit (kufirit) dhe kapacitetin ndër-kufitar. Pika e liferimit (kufiri) dhe kapaciteti ndër-kufitar nuk mund të ndryshohen pa miratimin e KOSTT-it.

## **4. AFATET E PAGESËS DHE BARAZIMI PËRFUNDIMTAR**

Perioda e liferimit është \_\_\_\_\_. Në fillim të muajit kalendarik pas periudhës së liferimit Shitësi do të lëshojë një faturë ku përkufizohet sasia totale e energjisë elektrike që është liferuar në muajin paraprak.

Afati i pagesës nuk është më vonë se \_\_\_\_ ditë të muajit kalendarik pas muajit të liferimit.


## **5. ÇMIMI**

Çmimet do të caktohen në €/MWh ku përfshihen të gjitha shpenzimet, deri në pikën e specifikuar të liferimit.

## **6. DETYRIMET, TAKSAT DHE SHPENZIMET**

Shitësi do t'i bartë të gjitha shpenzimet, taksat dhe të gjitha detyrimet që rrjedhin nga liferimi i energjisë elektrike deri në Pikën e Liferimit.



	<b>Procedura për tregtimin e energjisë elektrike</b>	<b>PR-MO-11</b>
	<i>vers. 1.0</i>	<i>Faqe 17 nga 20</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

## 7. FORMA E KONTRATËS

Ofertuesi pranon Kontratën për Shitje dhe Blerje të Energjisë Elektrike që i është bashkëngjitur dokumentacionit tenderues të caktuar.

## 8. GARANÇIONI BANKAR PËR OFERTËN

Ofertuesi do të dorëzojë Garançonin Bankar për Ofertën (“të Pakushtëzuar”, “të Parevokueshëm”, “Pa të drejtë kundërshtimi”) në vlerë prej 5% të vlerës totale të Ofertës(ave).

## 9. VALIDITETI I OFERTAVE

Oferta duhet të jetë valide deri \_\_\_\_\_. Ofertat me valditet më të shkurtër nuk do të merren në shqyrtim.

## 10. ELABORIMI DHE PËRMBAJTJA E OFERTËS

Të gjitha Ofertat e përgatitura në përputhje me dispozitat e mësipërme do t'i dorëzohen:

Blerësit: \_\_\_\_\_


Adresa: \_\_\_\_\_

Oferta duhet të dorëzohet në një zarfe të vulosur me tekstin vijues:

“Për Tenderimin për Furnizim me Energji Elektrike (perioda nga \_\_\_\_\_ deri më \_\_\_\_\_)! Mos e hap! Ofertë për shitjen e energjisë elektrike!” si dhe me emrin e dhe adresën e Ofertuesit.

Bashkëngjitur me Ofertë duhet të jetë:

- a) Grancioni Bankar i Ofertës (dokument origjinal ose konfirmim SWIFT)
- b) Deklarate e Integritetit në përputhje me Shtojcën 1 (dokument origjinal)
- c) Dëshmia për aftësinë legale:
  - Certifikatën nga regjistri i bizneseve, regjistri gjyqësor (tregtim), regjistri profesional i ekspertëve të kualifikuar ose ndonjë regjistër tjetër ekuivalent
  - Licencën për tregtim të energjisë elektrike të lëshuar nga ZRrE për tregtarët që janë themeluar ose regjistruar në Kosovë ose nga shtetet përkatëse për tregtarë me energji elektrike që janë themeluar ose regjistruar jashtë Kosovës
  - Certifikatën për anëtarësimin në asociacionet e caktuar profesionale në qoftë se kërkohet nga Ofertuesi në shtetin amë për performancën e aktiviteteve në lidhje me lëndën e këtij tenderi.

	<b>Procedura për tregtimin e energjisë elektrike</b>	<b>PR-MO-11</b>
	<i>vers. 1.0</i>	<i>Faqe 18 nga 20</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- Dokumentacionin e lëshuar nga një institucion kompetent në shtete përkatëse, jo më të vjetër se 3 muaj nga dorëzimi i ofertë, që dëshmon se:
  - tregtari nuk është në procesin e bankrotimit,
  - tregtari ose përfaqësuesi ligjor i kompanisë nuk janë të dënuar me ndonjë vendim gjyqësor për vepra kriminale ose kundërvajtëse,
  - tregtari ose përfaqësuesi ligjor i kompanisë nuk janë të dënuar me ndonjë vendim gjyqësor për ndonjë keqpërdorim në lidhje me aktivitetet në tregtimin e energjisë elektrike .

Me këto dëshmi, Ofertuesi duhet të dëshmojë se ai është plotësisht i autorizuar dhe i aftë për realizimin e performancës në lidhje me lëndën e këtij tenderimi.

d) Dëshmitë për aftësitë biznesore:

- Listën e referencave të kontratave të ekzekutuara me sukses në tregtimin e energjisë elektrike gjatë periodës nga \_\_\_\_ deri në \_\_\_\_, duke specifikua emrat e klientëve dhe sasitë me vlerë minimale të barabartë me sasinë e liferuar në këtë tenderim.

e) Dëshmitë për kualifikimet financiare:

- Deklaratën e Ofertuesit që konfirmon se Ofertuesi i ka përmbushur obligimet e tij për pagesën e të gjitha taksave dhe taksat e obligueshme shtetërore, detyrimet për pagesë, etj. në shtetin e tij amë.


## 11. AFTET PËR DORËZIMIN E OFERTAVE

Ofertat me të gjitha elementet e bashkëngjitura të kërkuara duhet të pranohen në Zyrën e Regjistrimeve të Blerësit jo më vonë se \_\_\_\_\_ në h \_\_\_\_\_ (CET).

## 12. KLAUZOLAT E INTEGRITETIT

Nga Ofertuesi në këtë procedurë tenderuese pritet:

- Korrektësia në procedure e tenderimit dhe procedurën e prokurimit;
- Mos ekzistenca e ndonjë praktikë të ndaluar në lidhje me procedurën ofertuese përkatëse, e cila përfshinë veprime si korrupsioni, mashtrimi, ofrimi apo premtimi i disa përparësive të parregullta të cilat mund të ndikojnë në veprimet e ndonjë të punësuari,
- Që pajtohet me rishikimin e tërë procedurës së prokurimit nga një ekspert i pavarur dhe pranon detyrimet dhe sanksionet (penaltitë kontraktuese, shkëputjen e pakusht të kontratës) në qoftë se janë shkelur rregullat.

	<b>Procedura për tregtimin e energjisë elektrike</b>	<b>PR-MO-11</b>
	<i>vers. 1.0</i>	<i>Faqe 19 nga 20</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

Ofertuesi do të garantojë me shkrim këto që u thanë më lartë duke nënshkruar Deklaratën e Integritetit e cila është e bashkëngjitur me këtë Dokument për Ftesën për Ofertë.

### **13. AKTIVITETET PAS HAPJES SË OFERTËS:**

Kriteri për vlerësimi e Ofertave për çdo LOT të përmendura në Pikën 1 të kësaj Ftese për Tenderim është oferta më ekonomike e Ofertës i cili është në përputhshmëri me kushtet e këtij tenderimi.

Blerësi mbanë të drejtën e mos-pranimi të asnjërës nga Ofertat.

Blerësi duhet ta informojë Ofertuesin për vendimin final deri më \_\_\_\_\_ në h  
\_\_\_\_\_.

### **14. GARANIONI BANKAR I PERFORMANCËS:**


Garancioni duhet të përcaktohet në mes palëve dhe bankave adekuate me shabllonet që posedojnë dhe specifikat konkrete.

Garancioni i performancës duhet të jetë në vlerë [10%] të vlerës së kontratës.

Jo më vonë se 5 ditë pune nga nënshkrimi i kontratës, Ofertuesi do t'i dorëzojë Blerësit/Shitësit Garancionin e Performancës të lëshuar nga një bankë e pranueshme për Blerësin/Shitësin.

Në rast se Ofertuesi i nominuar nuk do të ofrojë Garancion të Performancës, Blerësi/Shitësi është i autorizuar të anulojë nominimin dhe të ekzekutojë të drejtën e vet për Garancionin Bankar të Ofertës.

Ofertuesi do t'i bartë të gjitha kostot përcjellëse të përgatitjes dhe dorëzimit të Ofertës dhe Blerësi/Shitësi në asnjë rast nuk do të jetë përgjegjës ose nuk do të ketë detyrim për këto kosto, pa marrë parasyshë rezultatet e këtij procesi të ofertimit.

	<b>Procedura për tregtimin e energjisë elektrike</b>	<b>PR-MO-11</b>
	<i>vers. 1.0</i>	<i>Faqe 20 nga 20</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

### SHTOJCA 3: Kontrata Individuale - Shabllon

## KONTRATA INDIVIDUALE

### Ndërmjet Blerësit/Shitësit dhe Tregtarit

<i>Periudha e Furnizimit</i>	Nga CET	Deri më CET	Kapacitetit i Kontratës	Sasia e Kontratës	Çmimi i Kontratës	Shuma totale
Data			MW	MWh	Euro / MWh	Euro
dd/mm/vvvv	00:00	01:00				
	01:00	02:00				
	.....	....				
	.....	....				
	22:00	23:00				
	23:00	00:00				
total						

Pika e Liferimit (Zona tregtuese)

*DAP Kufiri I Kosovës*

Niveli I Tensionit:

400 kV

Festat e Përrjashtuara:

Nuk aplikohet

Ky Konfirmim konfirmon se Kontrata Individuale ka hyrë në fuqi në përputhje me Kontratën Kornizë në lidhje me Liferimin/ Tërheqjen e Energjisë Elektrike në/nga Blerësi/ Shitësi dhe formojnë pjesë të Kontratës Kornizë. Në rast të çfarëdo mospërputhjes ndërmjet kushteve të këtij Konfirmimi dhe Kontratës Individuale, ju lutemi të na kontaktoni menjëherë

Për dhe në emër të

Për dhe në emër të

**Blerësi/  
Shitësi:**

**Tregtari:**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Data:

Data:

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_